

Qendra Kombëtare e Biznesit

RAPORT – 2021

Përmbajtja

A. MBI QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT	4
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BUXHETI (QKB)	5
B. KORNIZA LIGJORE DHE FUNKSIONET E QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT	7
B.1 FORMULARËT E APLIKIMIT SIPAS FORMËS LIGJORE:.....	9
C. REGJISTRI TREGTAR DHE REGJISTRIMI	11
<i>Regjistrimi</i>	11
D. REGJISTRI I LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE LEJEVE.....	12
E. SHËRBIMET FUNKSIONALE DHE DYTËSORE TË QKB	15
<i>Tabela 1. Shërbimet funksionale</i>	17
<i>Tabela 2. Shërbimet dytësore</i>	23
E.1 APLIKIMI ONLINE	24
E.2 REGJISTRIMI I VENDIMEVE/ AKTEVE TË GJYKATËS, ZYRËS PËRMBARIMORE OSE AUTORITETEVE TË TJERA PUBLIKE.	26
E.3 BULETINI I NJOFTIMEVE ZYRTARE	26
E.4 KONTROLLI I STATUSIT TË APLIKIMIT PËR REGJISTRIM/LINCENCIM.....	26
E.5 NËNSHKRIMI ELEKTRONIK.....	26
E.6 KËRKO PËR EMËR TË LIRË	26
E.7 PËRMIRËSIMI I IMAZHIT TË INSTITUCIONIT TË QKB-SË.....	26
F. ANEKSI I STATISTIKAVE.....	27
TABELA NR. 1 SHËRBIMET E OFRUARA NGA QKB	27
TABELA NR. 2. REGJISTRIMET E REJA SIPAS QARQEVE	30
TABELA NR. 3 REGJISTRIMET E REJA SIPAS KOMBËSISË.....	29
TABELA NR. 4 BIZNESET E REJA SIPAS FORMËS LIGJORE	30
TABELA NR. 5 BIZNESE TË REJA SIPAS GJINISË SË ORTAKËVE APO ADMINISTRATORIT	30
TABELA NR. 6 ÇËSHTJET E PROCESUARA NË SPORTELET E QKB-SË.....	31
TABELA NR. 7 BIZNESE TË REJA SIPAS GJINISË SË ORTAKËVE APO ADMINISTRATORIT.....	32
TABELA NR. 8 ÇËSHTJET E PROCESUARA NË SPORTELET E QKB-SË.....	32
G. RISITË.....	39

FAKTE			
17 473 subjekte të reja të regjistruara.	35 sportele në të gjithë territorin.	80 punonjës në zyrat qendrore dhe 75 punonjës të shpërndarë në 35 sportele.	55.04% aplikimeve janë kryer në sportelet e qarkut të Tiranës dhe 45.96% në qarqet e tjera
23 712 bilance të depozituara online.	12 801 096 klikime të faqes së web-it	342 277 është numri i transaksioneve për shërbimet online.	610 mesatarja e çështjeve ditore të procesura.
43% është rritur prezenca e bizneseve me pronësi të huaj krahasuar me vitin 2020.	20.92% më shumë regjistrime të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar	241 biznese të reja me pronësi shqiptare - e huaj.	5 716 bizneset në pronësi të femrave
Regjistrimi i biznesit në 24 orë.	100 lekë për çdo aplikim në sportel.	0 lekë për aplikimet online.	4 sekonda për gjenerimin e kerkimit të subjektit si dhe 9 sekonda për të gjeneruar ekstraktin e subjektit nga Regjistri Tregtar me Captcha.
78.94% e regjistrimeve të reja janë të formës person fizik..	22.01% e licencimeve të reja të subjekteve janë për leje mjedisore	32.7% është pjesëmarrja e femrave si administratore apo pronare në një biznes. (Për regjistrimet e reja).	41 332 klikime në ditë në adresën: www.qkb.gov.al .
38 305 aplikime në Regjistrin e Pronarëve Përfitues	3 344 subjekte total të licencuara.	6 871 aplikime për leje/licencë ku vetëm 5 829 prej kërkesave janë për pajisjen me leje/licencë të re.	84.4 % e subjekteve kanë aplikuar për pajisjen me leje të re.
5829 aplikime për pajisjen me Leje/Licence të re.	27.87% me shume administratore femra krahasuar me vitin 2020	3 320 është numri i publikimeve vjetore në Buletin	434 823 subjekte kanë përdorur shërbimin kontrollo statusin e aplikimit
28 562 kanë zgjedhur dhe përdorur shërbimin “kontrollo për emër të lirë”.	Rreth 460 889 subjekte kanë vizituar QKB-në	24 388 subjekte të regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues	151 705 çështje në vit të procesuara nga QKB-ja

A. Mbi Qendrën Kombëtare të Biznesit

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit në Republikën e Shqipërisë, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” në muajin dhjetor 2015, u krijua Qendra Kombëtare e Biznesit

Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 131/2015, u hartuan dhe hynë në fuqi aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, lidhur me statutin, strukturën, numrin dhe shpërndarjen e sporteleve të shërbimit të QKB-së në rrethe.

Kuadri i mësipërm ligjor dhe institucional për funksionimin e QKB-së, u mundësua me mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, projekti “Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis e BE-së (në vijim projekti i GIZ).

Krijimi i QKB-së mundëson ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit në një qendër të vetme me një ndalesë, duke sjellë në këtë mënyrë një reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative për bizneset që operojnë në Republikën e Shqipërisë, duke sjellë për pasojë përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit dhe rritjen e investimeve, qoftë vendase apo të huaja, në ekonominë e vendit tonë.

Gjithashtu, vlen për t’u theksuar se krijimi dhe funksionimi i QKB është mirëpritur nga subjektet që operojnë në tregun vendas, si dhe nga subjektet e huaja të interesuara të investojnë në Shqipëri, pasi tashmë i gjithë informacioni i nevojshëm për të operuar në tregun shqiptar mund të gjendet lehtësisht, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, në një qendër të vetme. Për më tepër, krijimi i kësaj qendre ofron një qasje europiane akoma më të madhe të Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve për biznesin.

QKB-ja shërben si sportel me një ndalesë ku kryhen të gjitha proceset e regjistrimit të biznesit, duke përfshirë edhe regjistrimin për efekt të taksave në nivel kombëtar dhe vendor, sigurimin shëndetësor e shoqëror dhe inspektoratin e punës.

QKB-ja e zhvillon aktivitetin e saj në 35 sportele në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në sportelin elektronik nëpërmjet portalit elektronik e-albania.

Çdo individ / subjekt, përmes këtij portali, mund të aplikojë për regjistrim fillestar, ndryshim në të dhënat e regjistruara, depozitim pasqyrash finaciare dhe raporteve vjetore të auditimit, të shkarkojë ekstrakte të nënshkruara në mënyrë elektronike nga regjistri tregtar, pajisje me licencë të grupit 1, 2 dhe 3, etj. Shërbimi on line ofrohet pa pagesë në më pak se 8 orë, përsa i përket procesit të regjistrimit të biznesit. Ndërkohë, përsa i përket procesit të licencimit/lejimit, aplikimet e paraqitura në sportelin elektronik, shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

QKB-ja është një institucion i hapur për të gjitha strukturat ligjzbatuese të vendit, puna e të cilëve lidhet ngushtë me funksionet e QKB-së. Tashmë ekziston një shkëmbim i të dhënave për bizneset, me strukturat e DPT-së, Inspektoratit Qendror, ILDKPI, DPSHTR, APP, DPGJC, dhe ministritë e linjës përgjegjëse për vendimarrjen në rastin e licencave të grupit 3.

Impakt të rëndësishëm në shkurtimin e kohës së regjistrimit të biznesit, ka patur dhe zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Gjendjen Civile, ku është mundësuar marrja e të dhënave për individë të regjistruar në regjistrin tregtar si persona fizik, ortakë/aksionarë, anëtarë apo përfaqësues të organeve drejtuese të subjekteve tregtare nëpërmjet regjistrit në kohë reale.

QKB-ja është institucioni i parë që ofroi regjistrimin online të biznesit nëpërmjet sportelit elektronik (projekti i parë i këtij lloji) dhe që vazhdon të zgjerojë gamën e shërbimeve online.

Qëllimi i punës së QKB-së mbetet ofrimi i një shërbimi sa më cilësor dhe krijimi i një kulture administrative të biznesit. Ne do vazhdojmë të jemi gjithmonë pranë biznesit me cilësi, shërbim e shpejtësi.

Gjithashtu, gjatë këtij viti është hartuar Guida e Biznesit, me asistencën e projektin Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Kjo guidë përmban informacion të plotë për subjektet për parimet e përgjithshme, përkufizimet ligjore, procedurat, afatet, dokumentacionin dhe insitucionet vendimmarrëse për regjistrimin dhe licencimi/lejimit të biznesit.

Me asistencën financiare të Bankës Botërore, QKB ka realizuar projektin “Përmisimi i cilësisë së Raportimit Financiar”, i cili mundëson një mënyrë të re të depozitimit të pasqyrave financiare në regjistrin tregtar, gjithmonë nëpërmjet sistemin online ku informacioni financiar do të jetë i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Kjo do të mundësojë rritjen e mëtejshme të transparencës për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të njësive ekonomike të regjistruara në regjistrin tregtar, si dhe përpunimin dhe gjenerimin e raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare.

Me qëllim lehtësimin e mëtejshëm të procesit licensimit, dhe në kuadër të reformës së derregullimit, janë reduktuar 2 licenca. në kuadër të reformës së derregullimit. Falë këtij reduktimit, krijohet lehtësi në procedurat për fillimin e biznesit dhe ushtrimin e aktiviteteve, të cilat tashmë nuk i nënshtrohen më procesit të licensimit. Konkretisht, eliminohen:

- Licenca “Ndërzim natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)”, me kodin II.2.A.2.
- Licenca “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet hidrokarbure”, me kodin IV.4.B.

Struktura organizative dhe buxheti (QKB)

Qendra Kombëtare e Biznesit, është organizuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 53 31.03.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Kombëtare të Biznesit”.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës Kombëtare të Biznesit është gjithsej 80 vetë. QKB-ja e zhvillon aktivitetin e saj në 35 sportele në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të gjitha aplikimet e kryera dhe veprimet që kanë lidhje me regjistrimin dhe licencimin/lejimin e bizneseve procesohen nga Drejtoria e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve e vendosur në zyrën qendrore në Tiranë.

Administrata e QKB-së, drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. QKB-ja është e organizuar në drejtori.

Drejtori i Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin teknik, organizativ, financiar dhe të burimeve njerëzore të QKB-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në veçanti, Drejtori i Përgjithshëm i QKB-së:

- a) Është autoriteti përgjegjës për drejtimin, organizimin dhe kryerjen e funksioneve të QKB-së sipas ligjit;
- b) Përfaqëson QKB-në në marrëdhënie me të tretët;
- c) Është përgjegjës për administrimin e pasurisë së QKB-së dhe buxhetit të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ç) Është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore të QKB-së, në përputhje me statutin;
- d) Është përgjegjës për ndjekjen dhe arritjen e objektivave specifike vjetore dhe të treguesve të cilësisë së shërbimit, të miratuara nga ministri;
- dh) Është përgjegjës për veprimet e lidhura me ngritjen dhe funksionimin e sporteleve të shërbimit;
- e) Shqyrton dhe zgjidh ankimet ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të QKB-së, sipas ligjeve funksionale.

Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm i QKB-së ushtron udhëheqjen metodologjike për zbatimin e procedurave që ndiqen, sipas ligjeve funksionale dhe nxjerr, për këtë qëllim, urdhra e udhëzime të detyrueshëm për nëpunësit e QKB-së dhe për të gjitha sportelet e shërbimit.

Drejtoria e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve

Drejtoria e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve është përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve të kryera për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e subjekteve që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, kjo drejtori siguron informacionin e nevojshëm për të gjitha çështjet që lidhen me regjistrimet në regjistrin tregtar, lëshimin e certifikatave, ekstrakteve të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve, informimin dhe këshillimin për procedurat e regjistrimit dhe të licencimit me qëllim përmbushjen e misionit të institucionit.

Drejtoria e Inovacionit dhe Regjistrave

Drejtoria e Inovacionit dhe Regjistrave është përgjegjëse për funksionimin e saktë të gjitha sistemeve të IT-së të QKB, përfshirë atë të regjistrave.

Gjithashtu, kjo drejtori është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe administrimin e përgjithshëm të Regjistrit Tregtar dhe Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe të burimeve njerëzore të QKB-së.

Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike

Drejtoria e Kërkimit dhe Udhëheqjes Metodologjike është përgjegjëse për kryerjen e trajtimit dhe interpretimit juridik të shkresave e korrespondencës zyrtare, si dhe merr pjesë në hetime administrative në emër të titullarit të QKB mbi bazën e ankimeve administrative për procesin e regjistrimit/licencimit/lejimit.

Gjithashtu, kjo drejtori përfaqëson institucionin në të gjitha shkallët e gjyqimit në rastet kur QKB-ja është palë në një proces gjyqësor, duke hartuar prapësime, rekurse etj.

Drejtoria e Sporteve

Me qëllim informimin dhe dhënien e asistencës sa më të mirë për të gjithë subjektet dhe individët e interesuar për procedurat e regjistrimit e licencimit/lejimit të biznesit, tashmë në QKB është ngritur dhe funksionon sporteli i informimit dhe asistencës. Falë kësaj strukture të re, synohet të rritet niveli dhe shpejtësia e ofrimit të shërbimit të informimit dhe asistencës procedurat e regjistrimit e licencimit/lejimit të biznesit. Gjithashtu, pranë këtij sporteli të gjithë palët e interesuara mund të marrë informacionin, kthim përgjigje, asistencë ligjore, të kontrollojë statusin e aplikimit dhe të marrë sqarime mbi pezullimin e refuzimin e një çështje.

Ndërkohë, të gjitha kërkesat për regjistrimin e licencimin/lejimin e biznesit vazhdojnë të paraqiten pranë sporteleve të regjistrimit të biznesit, lejeve/licencave/autorizimeve, në zyrat qendrore në Tiranë dhe në sportelet e shërbimit të QKB në rrethe.

Buxheti

Për vitin 2018, QKB-ja pati në dispozicion një buxhet në vlerën 194.123.641 lekë, ku 29.08% përbëhet nga transfertat e kushtëzuara për njësitë e vetëqeverisjes vendore, 31.68% zenë shpenzimet e personelit, 33.42% shpenzimet operative dhe 5.82% të totalit, shpenzime kapitali. Të ardhurat e siguruar nga tarifat e shërbimeve mbulojnë 27.03% të shpenzimeve.

B. Korniza ligjore dhe funksionet e Qendrës Kombëtare të Biznesit

Organizimi, funksionimi dhe procedurat e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit rregullohen nga kuadri ligjor dhe nënligjor si më poshtë:

Legjislacioni	Funksionet e QKB
Ligj Nr. 131/2015 Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit	mban regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit;

Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.	kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit
Ligji Nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë"	kryen regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës;
Ligji Nr.10137, datë 11.5.2009, "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"	lëshon certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, sipas përcaktimit të ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit;
VKM Nr.179, datë 09.03.2016 "Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Biznesit	publikon të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to;
VKM Nr. Nr.391, datë 03.05.2017 "Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit"	trajton procedurat e licencimit, të autorizimit apo të lejeve, të ndryshimit dhe revokimit të tyre, sipas ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;
Vendim Nr. 503, datë 1.8.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar	mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;
VKM Nr.537, datë 01.08.2007 "Për rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare".	siguron aksesin e lirë të publikut në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në përputhje me ligjin që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet;
VKM Nr. 863, datë 21.10.2015 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të QKB-së, Regjistri Tregtar"	informon dhe këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit;
VKM 538, datë 26. 05. 2009 , "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta"	jep mendim për çdo nismë ligjore apo nënligjore në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licencave, autorizimeve e lejeve;
VKM Nr.392, datë 03.05.2017, "Për një ndryshim në vendimin nr. 503, datë 1.8.2007, të këshillit të ministrave, "për miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të. Qendrës Kombëtare të Biznesit"	kryen studime për cilësinë e mjedisit rregullator, mbështet me informacion, analiza e këshilla ministrin, Këshillin e Ministrave apo institucionet qendrore dhe të pavarura, në lidhje me nismat e tyre normative dhe organizative në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të licencave, autorizimeve e lejeve, si dhe asiston në përgatitjen e politikave për përmirësimin e mjedisit rregullator në këto fusha

Urdhër Nr.184, datë 31.12.2013, "Për regjistrimin dhe depozitimin e bilancit vjetor kontabël"		
Urdhër Nr.70, datë 18.04.2016 për "Marrjen e masave për thjeshtëzimin e formalizimit të dokumentacionit të regjistrimit të biznesve në institucionet e administratës shtetërore"		
Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.		
Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Per procedurat Tatimore në Republikën e Shqiperise"		
Urdhër Nr.1556.1, datë 30.3.2016 "Për miratimin e numrit dhe përhapjes në territor të sporteleve të Qendrës Kombëtare të Biznesit"		
Urdhër Nr.2513, datë 30.03.2016 "Për miratimin e formatit të formularëve dhe çertifikatave për kryerjen nga Qendra Kombëtare e Biznesit të funksioneve të regjistrimit, licencimit dhe lejimit"		

Konkretisht, në bashkëpunim me ekspertët e projektit të GIZ, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, janë hartuar dhe pas miratimit të tyre, tashme po zbatohen që nga fillimi i vitit 2017, VKM Nr. Nr.391, datë 03.05.2017 "Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe VKM Nr. 392, datë 03.05.2017, "Për një ndryshim në vendimin nr. 503, datë 1.8.2007, të këshillit të ministrave, "për miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit"

B.1 Formularët e aplikimit sipas formës ligjore:

Forma, përmbajtja e formularëve dhe dokumenteve shoqëruese të nevojshme për të kryer aplikimin, në mënyrë të përmblendhur prezantohen si më poshtë:

Formularët	Forma juridike
Formularë aplikimi për regjistrim fillestar:	1. Personi fizik; 2. Shoqëri Kolektive, Komandite, Me Përgjegjësi të Kufizuar dhe të Thjeshta; 3. Shoqëri Aksionare; 4. Shoqëri Kursim Krediti; 5. Shoqëri të Bashkëpunimit Reciprok; 6. Degë dhe Zyra të Përfaqësimit të Shoqërive të Huaja; 7. Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor.
Formularë aplikimi për regjistrimin e ndryshimeve në të dhënat e regjistrimit:	1. Person fizik; 2. Shoqëri Kolektive, Komandite, Me Përgjegjësi të Kufizuar dhe të Thjeshta 3. Shoqëri Aksionare;

	4. Shoqëri Kursim Krediti; 5. Shoqëri të Bashkëpunimit Reciprok; 6. Degë ose Zyra të Përfaqësimit të Shoqërive të Huaja; 7. Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor.
Formularë aplikimi për riorganizimin e shoqërive:	1. Njoftimi i projektbashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re; 2. Miratimi i bashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re; 3. Njoftimi i projektbashkimit me përthithje nga një shoqëri ekzistuese; 4. Miratimi i bashkimit me përthithje nga një shoqëri ekzistuese; 5. Njoftimi i ndarjes (ndarje në favor të shoqërive të themeluara rishtazi); 6. Miratimi i ndarjes; 7. Njoftimi i projekt ndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese); 8. Miratimi i ndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese); 9. Thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit - Shpallja 1; 10. Thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit - Shpallja 2; 11. Miratimi i shndërrimit.
Formular aplikimi për çregjistrim	1. Formular aplikimi për fillimin e procedurës së likuidimit; 2. Formular aplikimi për çregjistrim të: a) Personit fizik b) Personit juridik
Formular aplikimi për depozitimin e bilancit	1. Formular aplikimi për depozitimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit.
Formularë të tjerë dhe formatet e kthimit të përgjigjes për çdo veprim të kryer në regjistrin tregtar	1. Ekstrakte (të thjeshta dhe historike) të regjistrin tregtar për çdo subjekt që regjistrohet në regjistrin tregtar; 2. Vërtetim i kryerjes së aplikimit; 3. Vendimi i pezullimit; 4. Vërtetimi i kryerjes së regjistrimit; 5. Format i aplikimit për korrigjim; 6. Formulari i njoftimit të pezullimit; 7. Formulari i refuzimit të regjistrimit; 8. Certifikatë regjistrimi; 9. Certifikatë çregjistrimi; 10. Format i rezervimit të emrit.

	11. Formulari për tërheqjen e kopjes së dokumentacionit.
Vërtetimi Aplikimi për licencim/lejm	1. Aplikim i ri për pajisjen me licencë/leje 2. Aplikim për zëvendësim titulli 3. Aplikim për revokim vullnetar të titullit 4. Aplikim për ndryshim të të dhënave të titullit që nuk prekin dhe/ose prekin kriteret e licencimit/lejimit 5. Aplikim për shtryje afati të lejes së mjedisit dhe lejes minerare 6. Aplikim për rishikimi të kushteve të lejes së mjedisit 7. Aplikim për ankim administrativ

C. Regjistri tregtar dhe regjistrimi

Regjistri është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit. Regjistri mbahet në format elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, regjistrohen nga QKB-ja në format elektronik në dosjen e subjektit në regjistër.

Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese:

- a) të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, ruhen dhe arkivohen nga QKB-ja vetëm në format elektronik;
- b) të paraqitura në format shkresor, konvertohen dhe ruhen nga QKB-ja në format elektronik.

Regjistri tregtar përmban:

- Të dhënat e identifikimit të subjektit, të dhënat për formën e subjektit (nëse është person fizik/juridik etj);
- Të dhëna që i përkasin themelimit;
- Të dhënat për vlerën e kapitalit themeltar të nënshkruar, numrin dhe vlerën e aksioneve;
- Të dhëna për organizimin e subjekteve;
- Çdo ndryshim në status;
- Veprimtarinë e subjektit;
- Vendi i ushtrimit të veprimtarisë;

- Të dhënat e identifikimit të administratorit në lidhje me përfaqësimin;
- Të dhëna të tjera të parashikuara me ligj.

Regjistrimi

Aplikimi për regjistrim kryhet elektronikisht nëpërmjet sportelit elektronik (aplikimi online) ose në sportelet e QKB-së në qendër, njësitë e qeverisjes vendore apo dhomat e tregtisë, si dhe në zyrat e noterëve (vetëm aplikimi on line).

Procedurat e regjistrimit të biznesit kalojnë në dy faza:

Faza e parë: Aplikimi për regjistrim. **Faza e dytë:** Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja.

Faza e parë/Aplikimi për regjistrim	Faza e dytë/Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja
Aplikimet në sportelet pritëse	Aplikimet shqyrtohen nga Drejtoria e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve Qendër në Tiranë
- Kryerja e pagesës së tarifës përkatëse (100 lekë) - Paraqitja fizike e aplikantit në çdo sportel shërbimi të QKB-së; - Paraqitja e dokumentit për pagesën e tarifës përkatëse (100 lekë); - Dokument identifikimi i aplikantit; - Plotësimi i formularit të aplikimit sipas llojit të regjistrimit; - Dorëzimi i dokumenteve shoqëruese; - Nëpunësi i sportelit ndihmon aplikantin, që paraqitet për aplikim për plotësimin e formularit; - Nënshkrimi i formularit të aplikimit nga aplikuesi dhe nëpunësi i sportelit; - Merret pamja elektronike e formularit të aplikimit dhe dokumenteve shoqëruese; - Nëpunësi i sportelit lëshon konfirmimin nga sistemi elektronik sipas formatit të miratuar; - Konfirmimi përmban edhe numrin e aplikimit (çështjes) të dhënë automatikisht nga sistemi i informatizuar (CN);	- Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së verifikon identitetin e nënshkruesit; - Regjistruesi verifikon faktin nëse aplikanti është person i autorizuar për të bërë regjistrimin; - Verifikon plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara në formularin e aplikimit, si dhe dokumentet shoqëruese; - Verifikon paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen; - Verifikon faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë formularin; - Verifikon faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik; - Verifikon nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet; - Verifikon pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim;
Aplikimi online	

- Aplikanti nuk paraqitet fizikisht në sportelet e QKB-së; - Dokument identifikimi i aplikantit; - Plotësimi i formularit të aplikimit sipas llojit të regjistrimit dhe nënshkrimi elektronik; - Dërgimi i dokumenteve shoqëruese në QKB; - Sistemi i QKB-së lëshon konfirmimin përkatës sipas formatit të miratuar; - Konfirmimi përmban edhe numrin e aplikimit (çështjes) dhënë automatikisht nga sistemi i informatizuar (CN).	- Verifikon faktin nëse aplikanti ka shlyer sanksionet administrative të dhëna dhe ka kryer regjistrimet e kërkuara sipas nenit 46 të këtij ligji.
---	--

D. REGJISTRI I LICENCEVE, AUTORIZIMEVE DHE LEJEVE

Çdo licencë/autorizim/leje në Republikën e Shqipërisë, e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licenceve, Autorizimeve dhe Lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit, që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

Regjistri Kombëtar i Licenceve, Autorizimeve dhe Lejeve është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi/shpalljeje dhe si arkiv elektronik zyrtar, si dhe siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve. Regjistri Kombëtar mbahet nga QKB-ja, e cila siguron administrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të tij. QKB-ja, çdo institucion i pavarur dhe çdo institucion qendror, sipas shkronjës “b” të pikës 3 të nenit 15 të ligjit nr. 10081/2009, janë përgjegjës për administrimin dhe plotësimin, sipas këtij ligji, të Regjistrin Kombëtar për pjesën e licenceve/autorizimeve/lejeve në kompetencë të tyre. Regjistri është lirisht i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim të të dhënave, të cilat janë me akses të kufizuar apo të ndaluar, sipas legjislacionit në fuqi

Regjistri organizohet në tri pjesë:

a) regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve, i cili përmban të gjitha projekt aktet e nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licencimit/autorizimit/lejeve, raportin përkatës të vlerësimit të pasojave dhe mendimin këshillimor të QKB-së.

b) regjistri informativ, sipas kategorive të licenceve, autorizimeve dhe lejeve, i cili përmban, për çdo kategori licence/autorizimi/lejeje, të paktën, këto lloje të dhënash:

- kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- kriteret dhe detyrimet e licencimit, të autorizimit apo lejimit, dokumentet shoqëruese, që duhen paraqitur dhe formularët e aplikimit;

- procedurat e aplikimit, të shqyrtimit dhe vendimmarrjes;
- udhëzimet për bërjen e kërkesave.

c) regjistri aplikativ përmban këto të dhëna:

- çdo kërkesë për pajisjen me licencë/autorizim/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të;
- çdo vendim të ndërmjetëm të institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të licencimit/lejimit;
- çdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkesë;
- çdo vendim për urdhërimin e ripërmbushjes së kriterëve apo të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve të licencës/autorizimit/lejes apo pezullimin e licencës/autorizimit/lejes;
- çdo vendim për revokimin e një licence/autorizimi/lejeje;
- çdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat “b” deri në “d” të kësaj pike;
- çdo licencë/autorizim/leje të dhënë e të vlefshme;
- vendimet e gjykatës, për heqjen titullarit të një licence/autorizimi/lejeje të së drejtës, për të ushtruar veprimtarinë e licencuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të së mirës publike;
- çdo vendim tjetër për një licencë/autorizim/leje të caktuar.

Çdo institucion tjetër, sipas pikës 5 të nenit 20 të këtij ligji, me kompetencë në shqyrtimin e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejes, ka akses në Regjistrin Kombëtar, për të publikuar vendimin e tij në procesin e shqyrtimit të kërkesës për licencim/autorizim/leje. Gjithashtu, çdo institucion me kompetenca të caktuara për trajtimin e një kërkesë ose me kompetenca inspektuese, pezulluese, revokuese apo që zgjidh një ankim administrativ ndaj vendimeve të marra në ushtrimin e këtyre kompetencave, ka akses të drejtpërdrejtë në regjistrin, për të publikuar kërkesat, ankimet dhe vendimet përkatëse dhe është i detyruar për të publikuar, përkatësisht, ankimin dhe vendimin e tij, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligji.

Në zbatim të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” tashmë është miratuar VKM nr. 538, datë 26.05.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar, ku përcaktohen qartësisht kriteret, procedurat dhe afatet për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet QKB-së. Licencat dhe lejet e listuara në shtojcën e ligjit nr. 10081 ndahen më tej në licenca dhe leje që trajtohen nga ose nëpërmjet QKB-së si dhe në licenca dhe leje që trajtohen pa përfshirjen e QKB-së, përkatësisht Aneksi I dhe Aneksi II i VKM Nr. 538.

Licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet QKB-së ndahen më tej në 3 grupe:

- a) Grupi 1 përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kriterëve bazohet vetëm në vetëdeklarimet e kërkuarit.
- b) Grupi 2 përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat vlerësimi i përmbushjes së kriterëve, përveçse në vetëdeklarimet e kërkuarit, bazohet, për të paktën njërin nga kushtet, edhe në dokumentet provuese, të paraqitura nga kërkuari.

c) Grupi 3 përfshin ato kategori ose nënkategori, për të cilat, përveç sa parashikohet në pikat 2 e 3 të këtij neni, vlerësimi i përmbushjes së kriterëve, për të paktën njërin prej tyre, bazohet edhe në kryerjen e një procesi inspektimi, testimi, gare, interviste, dëgjimi apo metode tjetër vlerësimi.

Procedura e aplikimit fillon me paraqitjen e përfaqësuesit ligjor apo të një personi të autorizuar të subjektit që do të pajiset me leje apo licencë, pranë sporteleve të QKB-së. Në këtë moment, nëpunësi i sportelit, pasi vërteton identitetin dhe vlefshmërinë e autorizimit të aplikantit, krijon në sistem një çështje të re, e cila ka edhe një numër unik LC-..... Dokumentet përkatëse (dokumenti i identifikimit, i njohur nga ligji, i personit që paraqet kërkesën në emër të subjektit, akti i regjistrimit të subjektit sipas legjislacionit në fuqi, autorizimi që vërteton se personi i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të kërkuar licencën dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të subjektit, si dhe dokumentet provuese të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse) paraqiten nga aplikuesi në origjinal, në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin apo në kopje të shoqëruara me origjinalin, që njësohen me origjinalin nga nëpunësi i sportelit, të cilat pas skanimit të tyre nga nëpunësi i sportelit të QKB-së, i rikthehen mbrapsht (mbahen vetëm formatet elektronike të dokumenteve), duke shmangur në këtë mënyrë kostot e fotokopjimit dhe të noterizimit të tyre. Në fund të procedurës së aplikimit, e cila zgjat mesatarisht nga 10 deri në 40 minuta, aplikanti pajiset me vërtetimin e aplikimit dhe çështja i kalon për shqyrtim nëpunësit të regjistrimit në Drejtorinë e Regjistrimit të Biznesit & Lejeve/Licencave/Autorizimeve.

Nëpunësi i regjistrimit shqyrton çështjet sipas radhës së paraqitjes së tyre dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, ai vendos miratimin/refuzimin e çështjes ose ia kalon çështjen për shqyrtim institucionit tjetër kompetent. Bazuar në ligjin nr. 10081, në varësi të licencave/lejeve për të cilat është bërë aplikimi, nëpunësi i regjistrimit duhet të marrë një vendim brenda 2 ditëve pune për grupin 1 dhe 4 ditëve pune për grupin 2, si dhe brenda 4 ditëve pune nëpunësi i regjistrimit duhet të vendosë për miratimin paraprak e të përcjellë elektronikisht kërkesat e grupit 3 tek institucioni tjetër përgjegjës për vendimmarrjen ose për refuzimin e tyre.

Për aplikimet e bëra për licencat/lejet e grupit 3, pas miratimit paraprak nga ana e nëpunësit të regjistrimit, çështja kalon elektronikisht tek Ministria e Linjës, e cila është edhe institucioni përgjegjës për vendimmarrjen. Ministria e Linjës shqyrton çështjet sipas radhës së paraqitjes së tyre. Pas shqyrtimit të përmbushjes të kriterëve të licencimit në kompetencë të tyre, duke kryer inspektim, vlerësim, testim apo ndonjë metodë tjetër përkatëse, vendos për miratimin apo refuzimin e aplikimit, brenda afateve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast të mospublikimit të përgjigjes brenda afateve të parashikuara, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër.

Përveç se aplikantët ose personat e tjerë të interesuar mund të ndjekin hap pas hapi në kohë reale statusin e një aplikimi, i cili mund të jetë “sporteli” “regjistruesi”, “institucioni tjetër”, “aprovuar”, “refuzuar”, QKB ka ofruar edhe shërbimin e informimit të aplikantëve, për statusin e aplikimit, me anë të postës elektronike dhe SMS.

Faza e parë: Aplikimi për licencim/lejim

Faza e dytë: Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja.

Faza e parë/Aplikimi për licencim/lejim	Faza e dytë/Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja
Aplikimet në sportelet pritëse	Aplikimet shqyrtohen nga Drejtoria e Regjistrimit të Biznesit dhe Lejeve/Licencave/Autorizimeve Qendër në Tiranë
- Kryerja e pagesës së tarifës përkatëse (100 lekë) - Paraqitja fizike e aplikantit në çdo sportel shërbimi të QKB-së; - Paraqitja e dokumentit për pagesën e tarifës përkatëse (100 lekë); - Dokument identifikimi i aplikantit; - Plotësimi i formularit të aplikimit sipas llojit të regjistrimit; - Dorëzimi i dokumenteve shoqëruese; - Nëpunësi i sportelit ndihmon aplikantin, që paraqitet për aplikim për plotësimin e formularit; - Nënshkrimi i formularit të aplikimit nga aplikuesi dhe nëpunësi i sportelit; - Merret pamja elektronike e formularit të aplikimit dhe dokumenteve shoqëruese; - Nëpunësi i sportelit lëshon konfirmimin nga sistemi elektronik sipas formatit të miratuar; - Konfirmimi përmban edhe numrin e aplikimit (kërkesës) të dhënë automatikisht nga sistemi i informatizuar (LC);	- Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së verifikon identitetin e nënshkruesit; - Regjistruesi verifikon faktin nëse aplikanti është person i autorizuar për të bërë regjistrimin; - Verifikon plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara në formularin e aplikimit, si dhe dokumentet shoqëruese; - Verifikon paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton plotësimin e kriterëve të licencimit/lejimit; - Verifikon faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë formularin; - Verifikon faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik; - Miraton/Refuzon kërkesën për licencat e grupit 1 dhe 2, dhe përcjell elektronikisht kërkesat e grupit 3 tek insitucioni tjetër përgjegjës për vendimmarrjen.
Aplikimi online	
- Aplikanti nuk paraqitet fizikisht në sportelet e QKB-së; - Dokument identifikimi i aplikantit; - Plotësimi i formularit të aplikimit sipas llojit të regjistrimit dhe nënshkrimi elektronik; - Dërgimi i dokumenteve shoqëruese në QKB; - Sistemi i QKB-së lëshon konfirmimin përkatës sipas formatit të miratuar; - Konfirmimi përmban edhe numrin e aplikimit (çështjes) dhënë automatikisht nga sistemi i informatizuar (CN).	

E. Shërbimet funksionale dhe dytësore të QKB

Qendra Kombëtare e Biznesit ofron për publikun 22 shërbime funksionale si në tabelën e mëposhtme nr. 1. Afati për marrjen e përgjigjes për çdo aplikim të kryer në sportel është 24 orë, shërbimi online ofrohet pa pagesë dhe në më pak se 8 orë.

Tabela 1. Shërbimet funksionale për regjistrin tregtar

QKB	Shërbimet funksionale që ofrohen për biznesin	Shërbi mi online	Shërbim në sportel	Tarifa në sportel	Afati kohor
	Verifikimi i mundësisë së regjistrimit të emrit	✓	✓	100	24 orë
	Rezervimi i emrit		✓	100	24 orë
	Transferimi i emrit të rezervuar		✓	100	24 orë
	Regjistrimi fillestar	✓	✓	100	24 orë
	Regjistrime të tjera të detyrueshme	✓	✓	100	24 orë
	Regjistrimi me kërkesë të çdo të treti të vendimeve të autoritetit publik, (përveç atyre të bëra nga vetë subjekti)	✓	✓	100	24 orë
	Regjistrime vullnetare	✓	✓	100	24 orë
	Çregjistrime		✓	100	24 orë
	Lëshimi i ekstrakteve për një të dhënë të regjistrin tregtar	✓	✓	100	24 orë
	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 1 fletë deri në 20 fletë	✓	✓	100	24 orë
	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 21 fletë deri në 100 fletë	✓	✓	500	24 orë
	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, mbi 100 fletë	✓	✓	1000	24 orë
	Lëshimi i kopjes së statutit		✓	100	24 orë
	Lëshimi i kopjes së bilancit		✓	100	24 orë
	Lëshimi i kopjes së listës së aksionarëve		✓	100	24 orë

	Lëshimi i kopjeve të dokumenteve të tjera shoqëruese (vetëm të një dokumenti)		✓	100	24 orë
	Lëshimi i dublikatës së certifikatës		✓	100	24 orë
	QKB-ja siguron përgatitjen dhe venien në dispozicion në ambjentet e saj të destinuara për pritjen e publikut në qendër, komuna e bashki, në faqen e saj të internetit, broshura informative si dhe formulare të detajuar dhe informues.	✓	✓	Pa pagesë	24 orë
	QKB-ja publikon dhe informon të interesuarit për tarifat e miratuara të shërbimeve që ofron.	✓	✓	Pa pagesë	24 orë
	QKB-ja mund të kryejë edhe funksione të tjera në ndihmë të biznesit të lidhura me funksione të saj që miratohen nga Ministri dhe përfitohen kundrejt pagesës.	✓	✓	Me pagesë	24 orë

Tabela 2. Shërbimet funksionale për regjistrin e lejeve, licencave dhe autorizimeve

